

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Gjuhë dhe letërsi angleze
Titulli i lëndës:	Morfologji e gjuhës angleze 2
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	E mërkurë. 12.30-14.00, salla 6
Mësimdhënësi i lëndës:	PhD. Afërdita Kasolli, MA
Detajet kontaktuese:	akasolli@hotmail.com ;
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Ky kurs shtjellon detajisht strukturat flektive të anglishtes bashkë me sistemin e saj ndajshesor. Procesi i formimit të fjalëve të reja dhe i atyre ekzistuese do të përfshijë një pjesë të madhe të orëve të mësimi nga kjo lëndë.</p> <p>Pjesët e ligjëratës dhe tipat e ndryshëm morfologjik të fjalëve, bashkë me nënkategorizimin e tyre, do të jenë në qendër të vëmendjes së këtij kursi, me theks të veçantë në sistemin emëror dhe foljor të anglishtes. Gjithnjë, duke i përfshirë të gjitha kategoritë e këtyre strukturave dhe aspektet e tjera të rëndësishme për zotërimin e tyre teorik dhe praktik. Përdorimi dhe zbatimi i teorisë së strukturave morfologjike në praktikë do të jenë qenësore, brenda dhe jashtë një konteksti të caktuar.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimi i këtij kursi është që studentët të njihen me konceptet themelore të strukturës gramatikore të anglishtes në nivel të fjalës si dhe me proceset themelore e dytësore të fjalëformimit në anglishten. Gjithashtu, studentët do t'i mësojnë në mënyrë të detajuar karakteristikat themelore të pjesëve të ligjëratës, thelbësore këto për procesin e mësimdhënies dhe të përkthimit.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në fund të këtij kursi një student, i cili do të vlerësohet se e ka mbaruar me sukses provimin, do të jetë në gjendje që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - t'i identifikojë dhe t'i veçojë të gjitha format themelore dhe flektive të anglishtes bashkë me kuptimet e tyre

	<p>- bëjë analizë në përbërës të drejtpërdrejtë në nivel të fjalës</p> <p>- t'i kategorizojë fjalët varësisht nga struktura dhe nga mënyra e formimit të tyre</p> <p>-t'i dallojë konceptet themelore të analizës gramatikore në përgjithësi dhe të analizës së fjalës në veçanti;</p> <p>-t'i identifikojë dhe t'i veçojë të gjitha format themelore të shtjelluara dhe të pashtjelluara të anglishtes bashkë me kuptimet e ndryshme të tyre</p> <p>-të bëjë analizë morfologjike të fjalës në nivel të një hierarkie më të lartë gjuhësore</p> <p>-t'i kategorizojë fjalët varësisht nga përfshirja e tyre në një tip të caktuar fjalësh, duke u mbështetur në formën dhe në kuptimin e tyre</p> <p>-t'i dallojë konceptet themelore të analizës t'i dallojë konceptet themelore të analizës fjalës në veçanti;</p>
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënërit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	5	2	10
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgaditja përfundimtare për provim	4	5	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)			
Projektet,prezentimet ,etj	1	8	8
Totali			140

Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave që ofrojnë bazën teorike dhe ushtrimeve që realizohen me punë në klasë si dhe me detyra të vazhdueshme në shtëpi.</p> <p>Mësimdhënia do të jetë e orientuar kah studentët,</p>
-------------------------------------	---

	me studentin në qendër, mësimdhënësi do ta kontrollojë rrjedhën e orës dhe të shpjegimit të koncepteve të diskutueshme dhe të paqarta.
Metodat e vlerësimit:	Vijimi i rregullt 10% Angazhimi dhe pjesëmarrja aktive 10% Testi i parë Testi i dytë Gjithsejt 100 %
Literatura	
Literatura bazë:	Huddleston & Pullum, The Cambridge Grammar of the English Language, Cambridge, UK, 2002; Quirk & Greenbaum, A Comprehensive Grammar of the English Language, Oxford, UK 2002, An English - English Dictionary, Longman, Cambridge, Collins or Oxford Publishing House, (any edition with more than 40.000 entries).
Literatura shtesë:	Jashar Kabashi, English Grammar - Morphology, Prishtinë, 2000
Plani i dizajnuar i mëimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Emir – tiparet themelore
<i>Java e dytë:</i>	Klasifikimi i emrave, shumësi i rregullt dhe i parregullt
<i>Java e tretë:</i>	Rasat e emrit/ gjinorja dhe karakteristikat e saj
<i>Java e katërt:</i>	Gjinitë e emrit
<i>Java e pestë:</i>	Përcaktorët (nyja e shquar /e pashquar dhe përcaktorët tjerë)
<i>Java e gjashtë:</i>	Përemrat dhe tipet e tyre
<i>Java e shtatë:</i>	Testi i parë
<i>Java e tetë:</i>	Përemrat vetor/ vetvetor/ pronor,
<i>Java e nëntë:</i>	Përemrat pyetës/ lidhor/e pacaktuar
<i>Java e dhjetë:</i>	Numërorët 22.4
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Mbiemrat
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Ndajfoljet 6.5.2015
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Lidhëzat
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Testi i dytë (final)
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Rekapitulim i të gjitha koncepteve dhe diskutimi i rezultateve të testeve të studentëve

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Telefonat mobil nuk lejohet të përdoren gjatë orës së mësimit, dhe meqë pjesëmarrja e studentëve llogaritet në notë, ata nuk mund të hyjnë dhe të dalin nga ora sipas dëshirës. Studentët inkurajohen të diskutojnë për çështje të ndryshme lidhur me njësinë e realizuar mësimore, pa e ofenduar apo diskriminuar tjetrin si dhe duke e respektuar mendimin e tjetrit.